

Siguri

Shkon për aksident, Policia i gjen pistoletë me gaz dhe 36 fishekë në veturë të riut në Gjakovë



Sinjali.com

07 Korrik 2026 09:07



Një aksident trafiku në fshatin Lugbunar të Gjakovës çoi në zbulimin e një arme dhe municioni brenda një automjeti, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se ngjarja ka ndodhur të dielën, rreth orës 14:30, kur hetuesit e Trafikut Rajonal kanë dalë në vendin e një aksidenti me lëndime për të kryer ekzaminimet.

Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, në automjetin e njërit prej pjesëmarrësve në aksident, Eduard Lleshi, 26 vjeç, është gjetur dhe sekuestruar një pistoletë me gaz, një karikator dhe 36 fishekë.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë edhe patrulla e Stacionit Policor në Gjakovë dhe Njësia e Hetimeve, të cilat kanë sekuestruar armën në cilësinë e provës materiale.

Pas trajtimit mjekësor, i dyshuari është intervistuar nga hetuesit.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit është iniciuar rasti për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, ndërsa Eduard Lleshi është liruar në procedurë të rregullt.

Shënim: Personat e apostrofuat në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera